

REPubLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 12, Datë 09/10/2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 16, datë 01.03.2017, e bërë nga z. Fitri, kundër Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a. (në vijim UKT sh.a.), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*Bindjeve politike*”.


Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Z. Fitri ka filluar punë pranë UKT sh.a., më datë 29.03.2010, me detyrë “*Teknik në dispozicion të Njesisë nr. 2*”. Në datë 02.10.2013 ankuesi ka lidhur kontratën e punës me punëdhënësin me nr. 1277/7, datë 02.10.2013. Marrëdhënia e Punës ndërmjet ankuesit dhe UKT sh.a., ka zgjatur deri më datë 30.12.2015, kur ankuesi është njoftuar me anë të Vendimit nr. 1190, datë 30.12.2015, për largimin e tij nga pozicioni i punës. Largimi nga UKT sh.a., është bërë me arsyetimin e ndryshimeve në Strukturën Organizative të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a., ku pozicioni i punës që ai mbante në Grupet e Prerjes, Hidraulikët dhe Punëtorët e Njesisë Tirana nr. 2, është shkurtuar.

Në këto kushte, z. Fitri pretendon se, fakti që ai është i anëtarësuar¹ në Partinë Demokratike të Shqipërisë, ka bërë që Drejtoria e Përgjithshme e UKT-së, të marrë vendimin për largimin e tij nga pozicioni i punës që mbante, pasi ky pozicion nuk është shkurtuar, por ai është zëvendësuar që ditën e nesërme të largimit nga puna.

¹ Vërtetuar kjo me anë të Kartës së Antarësisë datë 22.01.2015, në Partinë Demokratike të Shqipërisë.



Sipas shpjegimeve të dhëna nga Z. **Blina**, si dhe duke iu referuar rubrikave të plotësuara në formularin e ankesës, diskriminimi i pretenduar kishte ndodhur në datën **31.12.2015** dhe mbi këtë diskriminim, ankuesi ka marrë dijëni, po në datën **31.12.2015**.

Pas analizimit të ankesës nr. 16, datë 01.03.2017, të Z. **Blina**, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i nuk plotësonte kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Kështu, në nenin 33, pika 4, gërma dh), të këtij ligji parashikohet:

“4. Ankesa nuk pranohet nëse:

a).....

b).....

.....

dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose **më vonë se një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt**”.

Për sa më sipër, diskriminimi i pretenduar nga Z. **Blina** ka ndodhur në datën **31.12.2015** dhe mbi këtë diskriminim ishte marrë dijëni po në datën **31.12.2015**, ndërkohë që ankesa pranë Komisionerit është paraqitur në datën **01.03.2017**. Në këtë kontekst, rezulton se ankesa është paraqitur pranë KMD-së, më vonë se një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për diskriminimin e ndodhur. Pra, ankesa është depozituar tej afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi **ju rekomandon** që bazuar në ligjin Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje*”, ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,



VENDOSI:

1. Mospranimin e ankesës nr. 16, datë 01.03.2017, të Z. [Emri i personit], pasi kjo ankesë është paraqitur për shqyrtim pranë Komisionerit, më vonë se një vit nga marrja dijani nga ana e të dëmtuarit, për diskriminimin e ndodhur.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.



828

Hartoi: [Emri i autorit]
Pranoi: [Emri i autorit]
Datë: 01.03.2017



3

Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al